



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIK MALLAKASTËR

Ballsh më, 25.03.2026

PROCESVERBAL

I mbledhjes së radhës të Këshillit Bashkiak Mallakastër. Kryesues i mbledhjes është Z. Nexhmi Sulaj. Ora e mbledhjes: 14:00. Kryesuesi i mbledhjes deklaroi kuorumin prej 13 anëtarësh. Të pranishëm nga administrata: Znj. Etilda Dishaj, Z. Guri Nuhaj, Z. Besmir Selami, Znj. Mariola Shehaj, Z. Erjona Çelaj, Z. Aleksandër Rama, Znj. Kleidja Hoxhaj, Z. Izet Ymeraj.

Kryetari i Këshillit e hap mbledhjen me këtë rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës.
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes më datë 28.02.2026.
3. **Projektvendim Nr.14:** Për miratimin e listës për familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike me fondin deri në 6%.
4. **Projektvendim Nr.15:** Për miratimin e kërkesës së Bashkisë Mallakastër, së bashku me dokumentacionin tekniko ligjor, për akordimin e ndihmës financiare Z.Gëzim Shehaj, banor i lagjes Zhupanat, fshati Kutë, Nj.Ad. Kutë, Bashkia Mallakastër, banesa (dy katë) e të cilit është dëmtuar si pasojë e një shkarkese elektrike (rrufe) rënë më datë 15.02.2026.
5. **Projektvendim Nr.16:** Për miratimin e kërkesës së Bashkisë Mallakastër, së bashku me dokumentacionin tekniko ligjor, për akordimin e ndihmës financiare Z.Rrapo Myftaraj, banor i fshati Ninsh, Nj.Ad. Fratar, Bashkia Mallakastër, banesa (një katë) e të cilit është dëmtuar si pasojë e rënies së zjarrit më datë 01.03.2026.
6. **Projektvendim Nr.17:** Për miratimin e transferimit të përkohëshëm të nxënësve të shkollës 'Ismail Klosi', Ballsh.
7. **Projektvendim Nr.18:** Për miratimin e tavanëve përgatitore për programin buxhetor afatmesëm 2027-2029.
8. **Projektvendim Nr.19:** Për një ndryshim në VKB Nr.50, datë 23.12.2025 "Për miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të Bashkisë Mallakastër, institucioneve në varësi, funksioneve të transferuara dhe deleguara për vitin 2026, të ndryshuar.
9. **Projektvendim Nr.20:** Për miratimin e programit të transparencës për Bashkinë Mallakastër.
10. **Projektvendim Nr.21:** Për disa shtesa në vendimin Nr.45, datë 23.12.2025 'Për miratimin e listës së përfituesve të bursave për nxënësit që ndjekin arsimin në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar, për vitin shkollor 2025-2026'.

Kush është dakord me këtë rend dite? E hedhim në votim, votojnë 13 pro, 0 kundër, 0 apstenim. Miratohet.

Kalojmë te pika 2, lexohen vendimet vendimet e mbledhjes datë 28.02.2026.

Vendim Nr.09: Për miratimin e listës për familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike me fondin deri në 6%.

Vendim Nr.10: Për miratimin e raportit të performancës së Këshillit Bashkiak Mallakastër për vitin 2025.

Vendim Nr.11: Për disa ndryshime në VKB Nr.50, datë 23.12.2025 “Për miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të Bashkisë Mallakastër, institucioneve në varësi, funksioneve të transferuara dhe deleguara për vitin 2026, të ndryshuar.

Vendim Nr.12: Për miratimin e kriterëve dhe procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Vendor Të Rinisë si dhe mënyrës së organizimit dhe funksionimit të tij.

Vendim Nr.13: Për miratimin e listës dhe fondin e bashkëfinancimit të familjeve që do të përfitojnë nga programi i strehimit “Përmirësimi i kushteve të banimit për komunitetin e pafavorizuar

Vazhdojmë me pikën 3 të rendit të ditës, - **Projektvendim Nr.14:** Për miratimin e listës për familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike me fondin deri në 6%. Nëse keni ndonjë pyetje, jeni të lirë. Me qënë se s’ka asnjë pyetje dhe koment, e hedhim në votim, votojnë 13 pro, asnjë kundër, asnjë apstenim. Miratohet.

Kalojmë në pikën katër të rendit të ditës; **Projektvendim Nr.15:** Për miratimin e kërkesës së Bashkisë Mallakastër, së bashku me dokumentacionin tekniko ligjor, për akordimin e ndihmës financiare Z.Gëzim Shehaj, banor i lagjes Zhupanat, fshati Kutë, Nj.Ad. Kutë, Bashkia Mallakastër, banesa (dy katë) e të cilit është dëmtuar si pasojë e një shkarkese elektrike (rrufe) rënë më datë 15.02.2026.

Z. Lefter Rabiçaj: - unë kisha diçka, pse nuk ka një fotot nga jashtë të objektit për të parë që është dy kate, dhe pse dy frigorifera dhe dy televizora janë vlerësuar me të njëjtin çmim?

Z. Izet Ymeraj: - këto çmime janë të vendosura nga Enti Kombëtarë i Banesave dhe Ministria e Financave, pra ne marrim çmimin referent, të cilat janë të vendosur që në vitin 2017, dhe jo më larg se vjet kemi bërë një kërkesë për rishikim vlerash. Për sa i përket paisjeve ato paguhen me 50% të vlerës së tyre. Është e drejtë që thoni s'ka frigorifer me këtë vlerë; por kjo është referencë; ashtu si thuhet se kur dëmtohet çatia, duhet paguar 50% e vlerës së çatisë, ndërkohë që çatia bëhet e gjitha e re.

Z. Adrian Hazizaj: në dokumentat që na keni vënë në dispozicioni shahim që ky nuk ka certifikatë pronësie, si procedohet në këto raste për rindërtim.

Z. Izet Ymeraj: Po, e drejtë, por ka A.M.T.P.-në ku cilësohet 300 m truall ku është ndërtuar banesa.

Z. Adrian Hazizaj: Urdhri i punës dhe procesverbali të plotësohet me nr. protokollit dhe datë.

Z. Izet Ymeraj: Procesverbali është mbajtur në datë 17.03.2026, për sa i përket plotësimit, po keni të drejtë, do t’ju themi atyre të protokollit të bëjnë plotësimet e duhura.

Z. Nexhmi Lulaj: Dokumentacioni duhet të jetë i saktë, nuk jemi kundër dhe për rastin tjetër.

E hedhim në votim, kush është pro 13, 0 kundër, 0 abstenim, miratohet.

E njëjta gjë dhe për **projektvendimin Nr. 16**, pika pesë e rendit të ditës; - Për miratimin e kërkesës së Bashkisë Mallakastër, së bashku me dokumentacionin tekniko ligjor, për akordimin e ndihmës financiare Z.Rrapo Myftaraj, banor i fshati Ninsh, Nj.Ad. Fratar, Bashkia Mallakastër, banesa (një katë) e të cilit është dëmtuar si pasojë e rënies së zjarrit më datë 01.03.2026. këtu shohim që dokumenti nuk është firmosur nga të gjithë anëtarët e grupit të punë, a mund ta dim arsyen pse, apo nuk ka qen dakord me këtë që na keni paraqitur?

Znj. Lindita Ymeraj: Njëri nga anëtarët e komisionit nuk ka qenë për arsye të një fatkeqësie familjare.

Z. Lefter Rabiaj: Kush fond e mbulon shpenzimin për këto?

Z. Izet Ymeraj: Fondi i emergjencave civile.

Z. Nexhmi Sulaj: - e quajmë të votuar që me pikën pararendëse, pra jemi dakord. Miratohet.

Kalojmë në pikën gjashtë, për **projektvendimin nr. 17**- Për miratimin e transferimit të përkohëshëm të nxënësve të shkollës 'Ismail Klosi', Ballsh.

Znj. Lindita Ymeraj: Sipas vendimit që keni marrë më lart, si drejtoreshë e kësaj shkolle, më duhet një ambient për bazën materiale që do të jetë e vazhdueshme mbas rikonstruksionit të shkollës, plus na duhen punonjës për transferimin e bazës tjetër. Dhe për fikset e zjarrit çfarë do bëhet?

Z. Izet Ymeraj: Në maj plotësohet afati një vjeçar i kolaudimit të tyre dhe do t'i marrim ne në magazinën tonë.

E hedhim në votim, votojnë 13 pro, 0 kundër, 0 abstenim. Miratohet.

Kalojmë në pikën 7 të rendit të ditës, **projektvendimi Nr. 18** - Për miratimin e tavanëve përgatitore për programin buxhetor afatmesëm 2027-2029.

Z. Aleksandër Rama: Faza e parë fillon me paraqitjen e këtyre tavanëve që i përmbahet dhe P.B.A.-së që kemi miratuar në dhjetor 2025. Është ruajtur një rritje me 5% për çdo vit, në qershor është faza e dytë dhe faza finale në dhjetor, siç kemi bërë çdo vit. Është mbajtur i njëjti nivel për të tri vitet si për pagat dhe për shpenzimet operative. Investimet kanë qenë ato që janë parashikuar por do realizohen me bazë të të ardhurave që do mblidhen.

Z. Klodjan Shehaj: Tavanet për arsimin bazë, ka ndryshime me ulje në investim.

Z. Aleksandër Roma: Janë fonde që vijnë me delegim dhe te parashikimi kështu ka ardhur, kurse pagat janë planifikuar me rritje për 2024-ën. Nuk do ketë projekte për ndërtime të reja shkollash, mbasi numri i nxënësve vjen çdo vit me ulje.

E hedhim në votim, votojnë 13 pro, 0 kundër, 0 abstenim. Miratohet.

Kalojmë në pikën tetë, **projektvendimi nr. 19** - Për një ndryshim në VKB Nr.50, datë 23.12.2025 "Për miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të Bashkisë Mallakastër, institucioneve në varësi, funksioneve të transferuara dhe deleguara për vitin 2026, të ndryshuar.

Znj. Mariola Shehaj: Bazuar në V.K.M nr. 776, datë 19.12.2025, në institucionet arsimore, për nivelin e pagave për funksionet e deleguara, bazuar në këtë V.K.M ka dalë ky projektvendim me shtesë në pagë sipas lidhjes që ju është dërguar.

E hedhim në votim, 13 pro, 0 kundër, 0 abstenim. Miratohet.

Kalojmë në pikën 9 për **projektvendimin Nr. 20** - Për miratimin e programit të transparencës për Bashkinë Mallakastër.

Znj. Mariola Shehaj: - Transparenca e materialeve në faqen ëeb, kërkohet sipas një modeli, i cili ka ardhur nga Komisioneri i të Drejtës për Informim dhe Mbrojtjes së të Dhënave Personale, pra të bëhet një model i përbashkët për të gjitha bashkitë, për sa i përket transparencës në faqen ëeb. Të ilat afatin e fundit kohor kanë datën 30 mars.

E hedhim në votim, votojnë 13 pro, 0 kundër, 0 abstenim. Miratohet.

Kalojmë në pikën dhjetë, **projektvendimi Nr. 21**, për disa shtesa në vendimin Nr.45, datë 23.12.2025 'Për miratimin e listës së përfituesve të bursave për nxënësit që ndjekin arsimin në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar, për vitin shkollor 2025-2026'.

Znj. Mariola Shehaj: E bëmë gati projektvendimin, por pritëm deri sot mos vimin kërkesa të reja, madje janë dhe dy emra të tjerë shtesë, në listën që keni Sibora nuk e ka të shënuar atësinë, por është parë për arsye ekonomike.

Z. Lefter Rabiçaj: Kanë bërë kërkesë për fëmijën e Z. Nertil Yzeiraj, a mund t'a shtojmë?

Znj. Mariola Shehaj: Po, më jepni emrin.

E hedhim në votim, votojnë 13 pro, 0 kundër, 0 abstenim. Miratohet.

Kemi një kërkesë nga Znj. Emanuela Metaj, Gjerbës, më është zënë rruga nga banorët e tjerë dhe s'më lejojnë të hyj as te shtëpia e as te ara. Z. Baki Resulaj më ka zënë rrugën.

Z. Guri Muhaj: Zonja pretendon për këtë problematikë, është trajtuar nga grupi i punës, është cilësuar rrugë are. E kemi trajtuar dhe brenda një muaji, por po presim të vijë mjetet sepse kur të vijë momenti që do çojmë mjetet, sepse s'kemi arritur akoma te rrugët e arave.

Faleminderit për prezencën në mbledhje sot!

**MBAJTËS I PROCESVERBALIT
SEKRETARI I KËSHILLIT**

Zinaida Ahmetaj